

# Brugëtimi I gjatë i të rinjve nga listat deri tek karriget e Këshillit Bashkiak



## KËSHILLI BASHKIAK

### FLETË VOTIMI

KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË

NR.	PARTIA	KANDIDATI	SHENJE
1	BASHKË FITOJËME		BF
2	PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË	EDI RAMA	PS
3	PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE E SHQIPËRISË	AGRON DUKA	PAA
4	PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE	FATMIR MEDIU	PR
5	PARTIA LEVIZJA E LEGALITETIT	SHPËTIM AKHANI	PLL
6	PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE	PASKAL MILO	POS
7	ALEANCA LIBERALE E DËJATHË		ALD
8	PARTIA SOCIALDEMOKRATE	TOM DOSHI	PBD
9	PARTIA DEMOKRATIKE	ENKELEJD ALIBEAJ	PD
10	ALEANCA PROGRESISTE L.ZH.K	DASHAMIR SHEHRI	L.ZH.K
11	FRYMA E RE DEMOKRATIKE	SALI SHEHRI	FRD
12	PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM OHE UNITET	SHPËTIM KERRI	PDIU
17	ALEANCA ARMBNORE KOMËTARE	63ETI HDQJ	A.A.K
18	PARTIA BALLI KOMBETAR	ADRIATIK ALIHAJRI	P.B.K
24	PARTIA KONSERVATORE	BASHKIM HURBATI	K.P.T
25	REPUBLICANET	ERONIT NURDARI	R.P.T
26	FORUMI I BASHKISË		

## RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2023



AUTOR  
**KRISELDA  
DEDNDREAJ**

QENDRESA  
QYTETARE

**NED** NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY  
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## **Tabela e përmbajtjes:**

1. Hyrje;
2. Angazhimi i të rinjve në politikë dhe manifestimi i këtij angazhimi në pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale;
3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje;
4. Analizë e listave për Këshill Bashkiak të partive të mëdha e atyre më të reja;
5. Gjetjet Kryesore;
6. Rekomandime.

## Hyrje

Zgjedhjet Lokale të 2023 në Shqipëri, në ngjashmëri me zgjedhjet e viteve të kaluara, solli një nivel të ulët të kandidaturave të të rinjve për Këshill Bashkiak në të gjithë qytetet e Shqipërisë.

Duke qenë se ligji nuk ka të vendosur kuota të detyrueshme për pjesëmarrjen e të rinjve në lista, kjo i lë hapësirë partive politike për t'i zgjedhur ato vetë mbi numrat e të rinjve në listat e tyre të kandidaturave. Kjo gjë bën të mundur lehtësimin për abuzim nga partitë politike dhe vështirësimin e mundësisë për pjesëmarrje në vendimmarrje nga të rinjtë.

Bazuar në të dhëna nga *INSTAT*, popullsia nën 30 vjeç në Shqipëri zë 30% të popullsisë totale në vend, çka tregon se edhe rëndësia e pjesëmarrjes së kësaj grupmoshe në vendimmarrje ka rëndësi të lartë.<sup>1</sup> Për qindja e një grupi të caktuar të popullsisë duhet të reflektohet edhe në përfaqësinë e tyre në organet e qeverisjes dhe vendimmarrjes, e në këtë rast përfaqësia do të sigurohej nëpërmjet pjesëmarrjes proporcionale të të rinjve në Këshilla Bashkiak.

Listat për Këshill Bashkiak, edhe këtë vit, çalonin në numrat e të rinjve të moshave 18-29 vjeç, ku vihet re si karakteristikë edhe renditja e tyre në lista. Partitë e mëdha e më të vjetra në mënyrë rendore vendosin në krye të listave kandidatë të moshave më të mëdha, duke u' a lënë rradhët e fundit kandidatëve të rinj. Në këtë mënyrë, mundësia e të rinjve për të fituar mandatin në KB ulet masivisht.

Statistikat në Shqipëri tregojnë se, numri i grupmoshave të reja po ulet më nivele të larta si pasojë e emigracionit.<sup>2</sup> Dukshëm edhe të rinjtë të cilët kanë zgjedhur të vazhdojnë jetesën në Shqipëri, nuk bëhen dot pjesë aktive e mirëqeverisjes dhe vendimmarrjes. Kjo vihet re edhe nga niveli i ulët i votuesve të rinj. Statistikat tregojnë se vetëm 12% e të rinjve - votues për herë të parë në Shqipëri, morën pjesë këtë vit në zgjedhje, duke ngritur pyetje mbi arsyet e numrave të ulët të të rinjve në procesin e votimit. Pavarësisht fushatave të shumta që KQZ ndërmorri, për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për të marrë pjesë në votim, numri vijoi të qëndrojë i ulët.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB/>

<sup>2</sup> [https://ies.lublin.pl/en/comments/albania-the-demographic-crisis-and-its-consequences/#:~:text=Moreover%2C%20the%20vast%20majority%20\(76,mostly%20young%20and%20educated%20people.](https://ies.lublin.pl/en/comments/albania-the-demographic-crisis-and-its-consequences/#:~:text=Moreover%2C%20the%20vast%20majority%20(76,mostly%20young%20and%20educated%20people.)

<sup>3</sup> <https://euronews.al/vetem-13-5-e-votuesve-per-herë-te-pare-moren-pjese-ne-zgjedhje/>

Në një studim të publikuar nga NDI<sup>4</sup>, në vitin 2020 grupmosha 18-29 vjeç përbënte grupmoshën me mungesën më të lartë të informacionit, sa i përket politikbërjes, apo qeverisjes e në të njëjtën kohë po kjo grupmoshë, shfaq interesin më të ulët mbi pjesëmarrjen në politikë.

Në po të njëjtin studim anketohen edhe të rinj të kësaj grupmoshe mbi arsyet e interesit të ulët që ata shfaqin për t'u përfshirë në qeverisje dhe vendimmarrje. Prej vitit 2016, rënia e angazhimit të tyre në partitë politike apo në forumet rinore ka ardhur me më shumë së 12%.

Nga anketimi, 40% i të rinjve besojnë se partitë funksionojnë vetëm për qëllimet e tyre personale, 22% shprehen se në partitë politike nuk u jepen hapësira për të pasur një influencë reale dhe 21% shprehen se brenda partive nuk dëgjohen për çka kanë për të thënë.

Zgjedhjet Vendore nuk ulën mjaftueshëm të rinj në karriget e Këshillave Bashkiakë edhe këtë vit. Kjo e përmendur edhe më lart, vjen si pasojë e mosdhënies së mundësive reale të rinjtë për të shprehur përfaqësinë e tyre.

Çka vihet re është se shumë prej të rinjve, pjesë të listave të kandidaturave për KB, nuk janë të angazhuar në skenën e veprimtarisë politike, ku disa prej tyre vijnë thjeshtë si pasojë e lidhjeve familjare me individë - pjesë të partive.

Diferencimi mes përfaqësisë rinore në partitë e mëdha e më të vjetra nga ato më të reja është një tjetër faktor i cili kërkon diskutim, duke qenë se megjithëse numrat më të lartë të të rinjve gjenden në listat e partive të vogla, vota e të rinjve tregon tendencë për të shkuar tek partitë e mëdha.

## **Angazhimi i të rinjve në politikë dhe manifestimi i këtij angazhimi në pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale**

Të rinjtë shqiptarë në shumicën e tyre janë totalisht të paangazhuar në politikë. Në një studim të WFD<sup>5</sup>, më pak se 20% e të rinjve janë të përfshirë në angazhim politik si aktivistë apo pjesë të partive politike.

Te po i njëjti studim, shfaqet se mbi 60% e të rinjve nuk besojnë se politika përfaqëson interesat e tyre, apo është e aftë t'u sigurojë ndryshim mbi mirëqenien e jetesës së tyre e për këtë arsye nuk shohin mundësi që angazhimi do të sillte ndonjë përmirësim në jetën e tyre. Në këtë mënyrë zgjedhin të distancohen totalisht nga politika.

---

4

<https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Survey%202020%20English.pdf>

<sup>5</sup> <https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey-young-people-and-politics-in-albania-final.pdf>

Rinia është një ndër elementet e shtyllat kryesore të një shoqërie funksionale. Angazhimi aktiv i tyre në veprimtarinë politike të vendit arrin të garantojë e shëndoshë një ndër hallkat e demokracisë. Nëpërmjet angazhimit aktiv publik të të rinjve arrihet përmirësimi jo vetëm i përfaqësimit të grupit përkatës, por i të gjithë shoqërisë.

Në Shqipëri që në vitet e para të vendosjes së demokracisë, kanë filluar aktivitetin politik edhe forumet rinore të asokohe, kur një traditë e tillë vijon edhe sot. Mirëpo, vihet re se me rënien e numrave të të rinjve në Shqipëri, pjesëmarrja bie ndjeshëm edhe në angazhimin publik dhe politik.

Mënyra e funksionimit të forumeve rinore është e ndryshme në çdo parti politike, por një fakt për t'u përmendur është se një numër shumë i vogël i të rinjve - pjesë të forumeve, përzgjidhen nga partitë përkatëse për të qenë pjesë e listave për kandidatë në Këshill Bashkiak, çka bëhet tregues i mundësisë të një përfaqësie fiktive sa i përket rinisë e ata të cilët vërtetë anazhohen nuk fitojnë mundësi për përfaqësi.

Ky mund të jetë një faktor i cili ulë interesin e të rinjve për angazhim në politikën aktive, çfarë reflektohet me pas në përfaqësimin e gabuar për të rinjtë në qeverisje.

Partitë politike në programet dhe objektivat e tyre, në kohë fushate zgjedhore, nuk shfaqin shumë pika mbi fuqizimin e të rinjve, duke bërë që këta të fundit të mos jenë në fokus, megjithëse gjatë zgjedhjeve të rinjtë e forumeve janë ndër grupet më së shumti të përdorura për fushatë.

Si përmendur dhe më lart, shihet një diferencë jo e vogël mes partive të vjetra dhe atyre të reja në përfaqësimin rinor. Kjo u tregua edhe në listat e Këshillave Bashkiakë të Zgjedhjeve Lokale të këtij viti, te të cilat numrat më të lartë të të rinjve të renditur në lista vinin nga partitë e reja, ose të kandidatëve të pavarur.

## **Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje**

45% e të rinjve të pyetur në një sondazh nga WFD, besojnë se të rinjtë anëtarë të partive politike kopjojnë liderat e tyre, duke mos krijuar asnjë shembull të ri dhe të mirë për politikën në vend. Të rinjtë besojnë se numrat e grupmohës së tyre, të cilët janë anëtarë në partitë politike, nuk i përfaqësojnë vërtetë ata dhe problematikat e tyre, duke humbur besimin se çështjet rinore dhe studentore mund të adresohen dhe të gjejnë zgjidhje të vërteta brenda këtyre partive, por përkundrazi, të rinjtë në parti shërbejnë vetëm si vazhdimësi e agjendës së liderëve të tyre politik.

Reflektimi i mungesës së thellë të besimit të të rinjve në politikë dhe tek aktorët e politikës në vend shihet edhe tek numri shumë i ulët i pjesëmarrjes në votime, numër i cili bie ndjeshëm nga zgjedhje në zgjedhje.

Përfaqësia e ulët rinore përveçse në Këshilla Bashkiakë, u vu re ndjeshëm edhe në zgjedhjet për kryetar Bashkie, ku në 61 kryetarë Bashkie në Shqipëri, asnjë prej tyre nuk është nën moshën 30 vjeç. Situatë e njëjtë u shfaq dhe në Zgjedhjet Vendore 2019, ndryshe nga Zgjedhjet Vendore 2015, ku 3 nga 61 (4.91%) kryetarë Bashkie, ishin nën moshën 30 vjeç.<sup>6</sup>

Përfaqësia rinore shfaqet më e lartë në Këshilla Bashkiakë, sesa në kryetarë Bashkie, megjithëse edhe këtu numrat janë shumë të ulët. Një mekanizëm i cili mund të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në vendimmarrje është Këshilli Rinor Vendor.

Këshilli Rinor Vendor është i parashikuar në *nenin 10 të ligjit "për rininë"*<sup>7</sup>, por në shumicën e Bashkive nuk ekziston ende si mekanizëm. Kjo shkakton përfaqësi akoma edhe më të ulët të rinisë në vendimmarrje, pasi mundësia e vetme e të rinjve mbetet Këshilli Bashkiak e sipas të dhënave të nxjerra nga Qëndresa Qytetare, numri i të rinjve në lista për Këshill Bashkiak mbetet shumë i ulët edhe në Zgjedhjet Vendore 2023.

## **Analizë e listave për Këshill Bashkiak të partive të mëdha e atyre më të reja**

Sipas të dhënave të nxjerra nga KQZ, 288 është numri të rinjve të grupmoshës 18 deri në 29 vjeç të përzgjedhur fitues në Këshill Bashkiak në Shqipëri. Prej tyre 182 janë femra dhe 106 meshkuj.

Numri total i fituesve në të gjithë Bashkitë e Republikës së Shqipërisë në Zgjedhjet Vendore është 1613, çka e bën përfaqësinë rinore në Këshilla 17.85% të numrit total të fituesve.

Në Zgjedhjet Vendore 2023 në Këshillin Bashkiak **Tiranë**, fituan 34 kandidatë nga *Partia Socialiste e Shqipërisë*, 15 kandidatë nga koalicioni "*Bashkë Fitojmë*", 4 kandidatë nga *Partia Demokratike e Shqipërisë*, 3 kandidatë nga *Partia Socialdemokrate*, 1 nga *Aleanca Progresiste LZHK*, 1 nga *Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet*, 1 nga *Partia "Lëvizja Bashkë"* dhe 1 nga *Nisma Thurje*.

<sup>6</sup> [https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/NYC\\_KAS\\_2019.pdf](https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/NYC_KAS_2019.pdf)

<sup>7</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

Në 15 kandidatët e koalicionit “*Bashkë Fitojmë*” vetëm 4 prej tyre janë të grupmoshave 18-29 vjeç, te *Partia Socialiste* nga 34, 7 janë të rinj dhe *Partia SocialDemokrate* vetëm 1. Nga *Partia Demokratike* asnjë kandidat i kësaj grupmoshe nuk arriti të fitojë vendin në Këshill Bashkiak, sikurse *Aleanca Progresiste LZHK*, *PDIU* dhe *Nisma Thurje* nuk kanë asnjë të ri në Këshill Bashkiak. Ndërkohe që kandidatja e vetme, e cila është pjesë e Këshillit Bashkiak nga Partia “*Lëvizja Bashkë*”, është një e re.

Koalicioni “*Bashkë Fitojmë*” dhe *Partia Socialiste* kanë një numër relativisht të ulët të të rinjve përfaqësues në Këshill Bashkiak, megjithëse kanë numrin më të lartë të anëtarëve. *Partia Demokratike* përfaqësinë rinore në Këshill e ka 0. Ky bëhet tregues i faktit se, të rinjtë kanë zënë vende dytësore në listat e partive të mëdha, duke mos i'u dhënë mundësi reale përfaqësie.

*Nisma Thurje* në listën e Tiranës kishte 22 kandidatë të grupmoshave 18-29 vjeç ndërkohë që *Lëvizja Bashkë* 20 kandidatë, duke vendosur edhe të parën në listë një kandidate të kësaj grupmoshe.

Në analizë të listave, qasjes publike e gjithashtu platformave të partive dhe kandidatëve, partitë e reja duket se të rinjtë i kanë më në fokus se ato parti më të vjetra dhe të mëdha. Nëse për partitë e mëdha, të rinjtë janë një instrument shumë i mirë për fushatë zgjedhore, sa i përket çështjeve të brendshme dhe përfaqësimit të grupit përkatës por edhe më gjerë, të rinjve nuk u jepen të njëjtat mundësi. Kjo gjë nuk vihet re tek partitë e vogla, të cilat çështjet rinore i vendosin më në qendër duke u'a lënë këtë kompetencë vetë individëve dhe kandidatëve të kësaj grupmoshe.

**Berat** në këto zgjedhje për KB nxorri fitues vetëm 3 të rinj të grupmoshës 18-29 vjeç. Të 3 anëtarët e rinj të Këshillit Bashkiak i përkasin *Partisë Socialiste të Shqipërisë*. Kjo vjen edhe si pasojë e faktit se *Partia Socialiste* mban edhe numrin më të lartë të fituesve për KB të kësaj Bashkie.

Në Bashkinë e **Dibrës** nga 31 fitues për KB, 7 janë të rinj, ku prej tyre 2 janë pjesë e *Partisë Socialiste*, 4 nga *Partia SocialDemokrate* dhe 1 nga *PLL*. Koalicioni “*Bashkë Fitojmë*” megjithëse arriti të kishte 5 përfaqësues në KB, asnjë prej tyre nuk i përket grupmoshës 18-29 vjeç.

Në Bashkinë **Durrës** nga 51 anëtarë të zgjedhur në Këshillin Bashkiak, vetëm 4 prej tyre janë të rinj. *Partia Socialiste* megjithëse mban shumicën dërrmuese në KB me 28 anëtarë, vetëm 1 prej tyre është nën moshën 30 vjeç. 1 anëtar është zgjedhur edhe nga *Partia Demokratike*, koalicioni *BF*, si dhe 1 anëtar nga *PAASH*.

Bashkia **Vlorë**, në Këshillin e ri Bashkiak prej 51 anëtarësh, zgjodhi që vetëm 3 prej tyre t'i kishte të rinj nën moshën 30 vjeç. *Partia Socialiste e Shqipërisë* prej 33 kandidatëve fitues, vetëm një prej tyre është i ri.

Njësoj, 1 anëtar i kësaj grupmoshe ka arritur të jetë pjesë e KB Vlorë nga koalicioni “*Bashkë Fitojmë*” dhe nga *PAASH*. Ndërkohë *Partia Demokratike, LZHK, PR* dhe *PDS* nuk kanë asnjë anëtar nën moshën 30 vjeç - përfaqësues në Këshill.

Situatë e ngjashme shihet të jetë edhe në Bashkinë **Korcë**, ku prej 41 anëtarëve të KB, vetëm 4 prej tyre janë 18 deri në 29 vjeç. Njësoj si në shumicën e Bashkive, *Partia Socialiste* megjithëse me shumicën e anëtarëve në Këshill, përfaqësinë rinore e ka shumë të ulët - me vetëm 2 të rinj në KB të Bashkisë Korcë. Nga Koalicioni *BF* vetëm një i ri ka arritur të jetë pjesë e Këshillit. *AAK* gjithashtu ka 1 përfaqësues në KB dhe ky anëtar është nën 30 vjeç. *Partia Demokratike, PPA, PSD* dhe *PR* nuk kanë asnjë përfaqësues fitues të ri në KB.

Bashkia **Fier** nga 51 anëtarë në Këshill Bashkak, ka zgjedhur që 5 prej tyre të jenë të rinj, duke bërë që edhe në këtë Bashki përfaqësia rinore të jetë shumë e ulët, me vetëm 9.8%. Nga *Partia Socialiste* prej 33 anëtarëve vetëm 4 i përkasin grupmoshës nën 30 vjeç, ndërsa anëtari tjetër i kësaj grupmoshe që arriti të zgjidhej në KB është pjesë e Koalicionit *BF*. *Partia Demokratike, PSD, ALD* dhe *PDIU* nuk kanë asnjë të ri në Këshill Bashkiak.

Bashkia **Shkodër** zgjodhi 8 anëtarë nën 30 vjeç prej 51 anëtarëve të KB. 2 prej të zgjedhurve vijnë nga *Partia Socialiste*, ndërkohë që nga 12 të zgjedhur nga *PSD*, 3 janë të rinj. Nga Koalicioni *BF* dhe nga *FRD* ka nga 1 përfaqësues të ri. Edhe në këtë Bashki, *Partia Demokratike, ALD* dhe *PLL* nuk kanë asnjë të ri në Këshill Bashkiak.

**Lezha** është Bashkia me më shumë të rinj në KB ku prej 41 anëtarëve, 11 prej tyre janë të rinj nën 30 vjeç. Anëtarët në këtë Këshill vijnë prej shumë partive, por edhe në Lezhë - *Partia Socialiste* mban numrin më të lartë të tyre, megjithatë, përfaqësues të rinj nga *PS* janë vetëm 2. 3 anëtarë të rinj vijnë nga *PSD*, 1 nga Koalicioni *BF*, 1 nga *PDK*, 1 nga *PUK*, 1 nga *PLL* dhe 1 nga *PGJ*. Nga *Partia Demokratike, FRD, PDS, PASH, PAASH* dhe nga *AAK* nuk ka asnjë anëtar të ri. Nga *Partia Republikane* të 2 kandidatët fitues për KB janë të rinj.

Në Bëshkinë **Kukës**, 6 janë të rinj prej 31 anëtarësh të zgjedhur për KB në Zgjedhjet e 14 majit. Në ngjashmëri me Bashkinë Lezhë, KB Kukës është i ndarë mes shumë partive dhe shumica prej tyre nuk kanë arritur të dërgojnë asnjë kandidat nën 30 vjeç në karriget e Këshillit Bashkiak. *PS, BF, PAA* dhe *ALD* janë partitë të cilat kanë nga një përfaqësues të ri në Këshill. *Nisma Thurje* arriti të ketë 2 të zgjedhur në KB dhe të 2 i përkasin grupmoshës 18-29 vjeç.

Bashkia **Elbasan** ndjek të njëjtin trend me të gjithë Bashkitë e tjera të mëdha, ku nga 51 anëtarë vetëm 5 prej tyre janë përfaqësi rinore.



Përkatesisht 3 prej tyre janë pjesë e PS, 1 nga Koalicioni BF dhe një nga PD.

**Gjirokastra** ka KB me më pak zë rinor, duke pasur vetëm 1 anëtar nën 30 vjeç - nga 31 anëtarë të zgjedhur. Ky anëtar vjen nga Koalicioni "Bashkë Fitojmë", i cili dërgoi vetëm 5 anëtare në KB. Ndërkohë që është Partia Socialiste ajo e cila sërish mban shumicën dërrmuese me 21 anëtare, por që nuk ka asnjë anëtarë pjesë të grupmoshës 18-29 vjeç.

## Gjetjet Kryesore

Pjesëmarrja e ulët rinore në organet vendimmarrëse dhe në Qeverisjen Vendore vë në rrezik prioritizimin e çështjeve rinore, përfaqesimin real të të rinjve dhe problematikave të tyre.

Vihet re se partitë e mëdha megjithëse marrin shumicën e anëtarëve në KB, nuk i japin hapësirë të rinjve për të përfaqësuar grupin të cilit i përkasin. Duke krijuar mekanizma të cilat i'a vështirësojnë të rinjve mundësinë për t'u përzgjedhur si anëtarë në Këshill, si përshembull vendosja e të rinjve në fund të listave, këto parti thellojnë ciklin e padrejtësive në mënyrën sesi Këshillat përzgjidhen.

Partitë e reja dhe më të vogla janë më të hapura ndaj të rinjve dhe perfaqësisë rinore, ndërkohë që vota e të rinjve vazhdon të shkojë drejt partive të medha dhe jo atyre më të vogla.

## Rekomandime

Partitë politike, në veçanti partitë më të mëdha dhe të vjetra duhet të rrisin numrin e kandidatëve të rinj për Kryetarë Bashkie si dhe për Këshilla Bashkiakë.

Partitë politike duhet të vendosin në prioritet çështjet rinore dhe thellimin e angazhimit rinor në vendimmarje dhe qeverisje, apo në programet e tyre zgjedhore.

*Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve* duhet të ndërmarrë fushata më efikase për përfshirjen e të rinjve në votim dhe vendimmarje.

Ndryshmime ligjore për të rritur përfaqësinë e të rinjve në qeverisje, si vendosja e kuotave të moshës duke detyruar përfshirjen e grupmoshës nën 30 vjeç në lista për KB.

Partitë politike duhet të kenë garë të hapur sa i përket zgjedhjeve të këtyre të rinjve si kandidatura në lista për Këshill.

Duhet të bërë çështje prioritare krijimi i Këshillave Rinore Vendore, për të gjithë Bashkitë në Republikën e Shqipërisë. Ndërtimi i një mekanizmi të tillë do të nxiste përfshirjen e të rinjve në vendimmarje jo vetëm në qytetet e mëdha, por edhe ato më të vogla.

Të rinjtë duhet të luajnë një rol më aktiv në implementimin e politikave me në fokus rininë, si në nivel lokal e kombëtar.

Rritje e përdorimit të mjeteve *online* në mënyrë që komunikimi dhe arritja tek të rinjtë të jetë më e lehtë. Përditësim nëpërmjet mjeteve *online* është një faktor shumë i rëndësishëm për ta bërë shpërndarjen e informacionit më të thjeshtë e efikas veçanërisht tek të rinjtë.

## Bibliografia

Popullsia e Shqipërisë (no date) *Instat*. Available at: <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB/> (Accessed: 28 June 2023).

Meno, S. (2023) *Vetëm 13.5% E votuesve Për Herë të Parë Morën pjesë në zgjedhje*, *Euronews Albania*. Available at: <https://euronews.al/vetem-13-5-e-votuesve-per-here-te-pare-moren-pjese-ne-zgjedhje/> (Accessed: 28 June 2023).

(No date) *Dhe Aktet Nënligjore në zbatim të tij - arsimi.gov.al*. Available at: <https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf> (Accessed: 28 June 2023).

*Albania: The demographic crisis and its consequences* (2021) *Institute of Central Europe*. Available at: <https://ies.lublin.pl/en/comments/albania-the-demographic-crisis-and-its-consequences/> (Accessed: 28 June 2023).

*Albania political engagement 2020 - National Democratic Institute*. Available at: <https://www.ndi.org/sites/default/files/Albania%20Political%20Engagement%20Survey%202020%20English.pdf> (Accessed: 28 June 2023).

Peci, D. and Xhemollari, R. (no date) *Krk.al*. Available at: [https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/NYC\\_KAS\\_2019.pdf](https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/NYC_KAS_2019.pdf) (Accessed: June 28, 2023).

(No date a) *Data on youth in national parliament | Parline: The IPU's open data ...* Available at: [https://data.ipu.org/node/2/data-on-youth?chamber\\_id=13313](https://data.ipu.org/node/2/data-on-youth?chamber_id=13313) (Accessed: 28 June 2023).

(No date a) *National Survey - Westminster Foundation for Democracy*. Available at: [https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey\\_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf) (Accessed: 28 June 2023).

